

PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGURIA SH.A.

31 DHJETOR 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	1
Pasqyra e pozicionit financiar	5
Pasqyra e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse	6
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	7
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	8
Shënime për pasqyrat financiare	9
SHTOJCA 1 Pasqyrat plotësuese	39

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarin e Kompanisë së Sigurimeve Siguria Sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Kompanisë së Sigurimeve Siguria Sh.a ("Kompania"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025, pasqyrën e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë politikat materiale kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Kompanisë më 31 dhjetor 2025, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në përputhje me politikat kontabël të shpalosura në Shënimin 2A.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi IESBA), dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin "IESBA". Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Theksim i Çështjes

Pa modifikuar opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen në Shënimin 27b të pasqyrave financiare, i cili përshkruan procesin gjyqësor ndaj Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), një organizatë profesionale dhe jofitimprurëse, e themeluar nga kompanitë e sigurimeve të licencuara në Kosovë, përfshirë edhe Kompaninë. Siç shpaloset në këtë shënim, më 23 korrik 2025, Gjykata e Apelit ka nxjerrë një vendim kundër BKS në lidhje me këtë çështje. Më pas, me vendimin e saj të datës 20 janar 2026, Gjykata Supreme e Kosovës e ka kthyer çështjen në Gjykatën e Apelit për rigjykim. Për rrjedhojë, procedurat gjyqësore mbeten në vazhdim dhe rezultati përfundimtar është i pasigurt.

Siç shpaloset më tej në Shënimin 27b dhe Shënimin 25, bazuar në informacionin e disponueshëm dhe pas njohjes së një provizioni nga BKS në pasqyrat e saj financiare, menaxhmenti ka vlerësuar dhe ka njohur një provizion në shumën prej 146 mijë euro në pasqyrat financiare shoqëruese, që përfaqëson pjesën e Kompanisë në detyrimin e mundshëm që rrjedh nga kjo çështje gjyqësore. Provizioni është njohur mbi bazën e vlerësimeve më të mira të menaxhmentit në datën raportuese. Megjithatë, shuma e saktë e detyrimit financiar përfundimtar nuk mund të përcaktohet me siguri në këtë fazë, pasi varet nga rezultati përfundimtar i procesit gjyqësor në vazhdim. Për rrjedhojë, provizioni i njohur i nënshtrohet pasigurisë së konsiderueshme në vlerësim, dhe shuma përfundimtare mund të ndryshojë nga shuma e njohur aktualisht.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

Çështje të Tjera

Pasqyrat financiare të Kompanisë së Sigurimit Siguria Sh.A. për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 janë audituar nga një auditor tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pamodifikuar mbi këto pasqyra financiare më 7 prill 2025.

Informata tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informatat e tjera. Informatat tjera përfshijnë pasqyën shtesë e cila përmban "Margjinën e Solvencës", "Llogaritjen e Kapitalit" dhe "Mjaftueshmërinë e investimeve të aseteve në mbulim të provizioneve teknike". Opinioni ynë për pasqyrat financiare nuk mbulon informatat e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë formë sigurie apo konkluzioni lidhur me to. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informatat e tjera dhe, duke vepruar kështu, të shqyrtojmë nëse informatat e tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të fituara në auditim, ose përndryshe duket se përmbajnë gabime materiale. Nëse, bazuar në punën që kemi bërë në informacionet e tjera të fituara para datës së këtij raporti të auditorit, dhe nëse ne konkludojmë se ka një gabim material të këtij informacioni tjetër, ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Lidhur me këtë dhe bazuar në procedurat tona të kryera, ne raportojmë se:

- informacionet e tjera, në të gjitha aspektet materiale, janë në përputhje me pasqyrat financiare të audituara;
- dhe bazuar në njohuritë dhe kuptimin tonë për Kompaninë dhe mjedisin e saj të fituar gjatë auditimit, ne nuk identifikuam ndonjë gabim material të fakteve në lidhje me informacionin tjetër.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me politikat kontabël të shpalosura në Shënimin 2A. dhe për ato kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likuidojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësia e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbuloj anomali materiale kur ato ekzistojnë. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimeve ose mashtrimeve dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontroleve të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.

Përgjegjësia e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare (Vazhdim)

- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruara, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Kompanisë. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Kompania të ndërpres veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar për qeverisjen, përveçse çështjeve të tjera, edhe fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

RSM Kosovo Sh.p.k.

RSM Kosovo Sh.p.k.

Prishtina, Republika e Kosovës

17 Prill 2026



Sadik Berisha

Auditor Ligjor

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2025

	Shënimet	31 Dhjetor 2025 EUR '000	31 Dhjetor 2024 EUR '000
PASURITË			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	6	1,082	870
Depozitat	7	14,505	11,682
Investimet ne letrat me vlere	7	4,125	5,082
Të arkëtueshmet nga sigurimet	8	1,753	1,299
Kostot e shtyra të përvetësimit	9	625	601
Prona, pajisjet	10	3,183	2,975
E drejta e shfrytëzimit te pasurive	11	342	311
Pasuritë e paprekshme	12	97	39
Prona Investuese	13	895	895
Pasuritë nga risigurimet	14	1,098	2,058
Pasuritë nga tatimi në fitim		40	-
Pasuritë tjera	15	656	640
GJITHSEJ PASURITË		28,401	26,452
EKUITETI DHE DETYRIMET			
EKUITETI			
Kapitali aksionar	16	19,503	19,503
Rezerva e rivlerësimit		534	534
Humbjet e akumuluar		(11,992)	(12,846)
GJITHSEJ EKUITETI		8,045	7,191
DETYRIMET			
Detyrimet e provizioneve teknike	17	12,431	11,545
Provizioni për prime të pafituara	18	6,636	6,427
Detyrim ndaj borxhit të varur	19	214	200
Detyrim ndaj tatimit në të ardhura		-	164
Detyrimet e Qirasë	20	356	324
Detyrimet nga sigurimi dhe detyrime të tjera	21	573	601
Detyrimet për çështje ligjore	27b	146	-
GJITHSEJ DETYRIMET		20,356	19,261
GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET		28,401	26,452

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve më 03 Prill 2026 dhe janë nënshkruar në emër të:


 Z. Fitim Rexhepaj
 Drejtor Gjeneral


 Z. Adhurim Kastrati
 Drejtor Financiar

PASQYRA E FITIMIT DHE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

	Shënimet	31 Dhjetor 2025 EUR '000	31 Dhjetor 2024 EUR '000
Primet e shkruara bruto	22	14,801	14,460
Minus: Primet e bartura tek risiguresit	22	(896)	(2,055)
PRIMET E SHKRUARA NETO		13,905	12,405
Ndryshimi bruto në provizionin e primeve të pafituara	18	(209)	(1,258)
Ndryshimi në pjesën e risiguresëve të rezervës së primit të pafituar	18	(859)	770
PRIMET E FITUARA NETO		12,837	11,917
Të ardhurat financiare neto	23	390	355
Të ardhura tjera	24	230	411
GJITHSEJ TË ARDHURAT		13,457	12,683
Shpenzimet e provizioneve teknike	17	(7,612)	(6,641)
Ndryshimi në kostot e shtyra të përvetësimit	11	23	70
Kontributi në BKS për shpenzimet administrative		(239)	(257)
Shpenzime tjera operative dhe administrative	25	(4,560)	(4,828)
GJITHSEJ SHPENZIMET		(12,388)	(11,656)
FITIMI PARA TATIMIT		1,069	1,027
Tatimi në të ardhura	26	(215)	(269)
FITIMI PËR VITIN		854	758
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse		-	-
GJITHSEJ FITIMI GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN		854	758

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

	Kapitali Aksionar EUR '000	Rezerva e Rivlerësimit EUR '000	Humbja e Akumuluar EUR '000	GJITHSEJ EUR '000
MË 01 JANAR 2024	19,503	534	(13,604)	6,433
<u>Transaksionet me pronarin</u>	-	-	-	-
Gjithsej trasaksionet me pronarin	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	758	758
Rivlerësimi i pronës & objektit	-	-	-	-
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
GJITHSEJ HUMBJET GJITHËPËRFSHIRËSE	-	-	758	758
MË 31 DHJETOR 2024	19,503	534	(12,846)	7,191
MË 01 JANAR 2025	19,503	534	(12,846)	7,191
<u>Transaksionet me pronarin</u>	-	-	-	-
Gjithsej trasaksionet me pronarin	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	854	854
Rivlerësimi i pronës & objektit	-	-	-	-
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
GJITHSEJ HUMBJET GJITHËPËRFSHIRËSE	-	-	854	854
MË 31 DHJETOR 2025	19,503	534	(11,992)	8,045

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

	Shënimi	31 Dhjetor 2025 EUR'000	31 Dhjetor 2024 EUR'000
AKTIVITETET OPERATIVE			
Fitimi i vitit para tatimit		1,069	1,027
<i>Rregulluar për zërat jo në para të gatshme:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,11,12	339	295
Provizionimi llogarive të arkëtueshme	25	140	70
Provizione për çështje ligjore	25	146	-
Fitimet nga shitja e veturave		(13)	-
Të ardhurat nga interesi	23	(419)	(378)
Shpenzimet e interesit	23	29	23
		1,291	1,037
<i>Ndryshimet në kapitalin punues:</i>			
Të arkëtueshmet nga sigurimi		(594)	239
Kostot e shtyra të përvetësimit		(24)	(69)
Pasuritë tjera qarkulluese		944	(473)
		1,617	734
<i>Ndryshime në detyrimet operative:</i>			
Detyrimet e provizioneve teknike		886	324
Provizioni për primet e pafituara		209	1,258
Të pagueshmet nga sigurimi dhe të tjera		4	(401)
Tatim mbi fitim i paguar		(417)	225
Interesi i paguar		(29)	(23)
Neto mjete monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		2,270	2,117
AKTIVITETET INVESTUESE			
Blerja e pronës dhe pajisjeve		(464)	(144)
Shlyerja nga shitja e veturave		23	-
Rritja/Zvogëlimi në depozita		(2,823)	(1,768)
Rritja/Zvogëlimi në letra me vlerë		957	2
Interesi i pranuar		419	378
Neto mjete monetare të përdorura në aktivitetet investuese		(1,888)	(1,532)
AKTIVITETET FINANCIARE			
Pagesa e detyrimeve të qirasë	12	(170)	(184)
Neto mjete monetare të përdorura në aktivitetet financiare		(170)	(184)
NDRYSHIMI NETO NË PARANË DHE EKVIVALENTËT E PARASË			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim		212	401
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim	6	870	469
PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË NË FUND	6	1,082	870

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

KS Siguria Sh.a. ("Kompania") është themeluar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës dhe është regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë me numër regjistrimi 70167671 si shoqëri aksionare. Kompania është 100% në pronësi të Banka Ekonomike Sh.A.

Kompania është e licencuar si kompani e sigurimeve jo-jetë. Aktiviteti kryesor i Kompanisë është sigurimi i përgjegjësisë ndaj palëve të treta për automjete motorike, si dhe klasa të tjera sigurimi si në vijim:

- Sigurimi i pronës;
- Sigurimi ndaj të gjitha rreziqeve në ndërtim (CAR);
- Sigurimi shëndetësor për udhëtime;
- Sigurimi nga aksidentet personale;
- Sigurimi gjithëpërfshirës i automjeteve motorike, etj.

Adresa e selisë së Kompanisë është Rr. Qamil Hoxha Nr., 51, 10000, Prishtina, Kosovo.

Më 31 dhjetor 2025, Kompania ka gjithsej 120 punonjës dhe menaxhment të lartë (31 dhjetor 2024: 129 punonjës dhe menaxhment i lartë).

Pasqyrat financiare të Kompanisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025 janë miratuar nga Bordi i Drejtorëve më 03 Prill 2026.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT

Politikat kryesore kontabël të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë konsistente për të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse është deklaruar ndryshe.

A. BAZA E PËRGATITJES DHE DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË ME IFRS

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e vazhdimësisë së aktivitetit dhe në përputhje me politikat kontabël siç janë shpalosur më tej në këtë shënim. Politikat kontabël të aplikuara bazohen kryesisht në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), përveç mosaplikimit të SNRF 17: Kontratat e sigurimit dhe SNRF 9: Instrumentet financiare. Këto standarde nuk janë zbatuar deri më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024, bazuar në njoftimin e Bankës Qendrore të Kosovës, të datës 29 dhjetor 2023, për shtyrjen e afatit të zbatimit të këtyre standardeve. Zbatimi i SNRF 17 do të hyjë në fuqi për periudhën vjetore raportuese që fillon më 1 janar 2026.

Si rrjedhojë, këto pasqyra financiare nuk mund të konsiderohen si të përgatitura në përputhje të plotë me SNRF. Bazat e matjes përshkruhen më hollësisht në politikat kontabël më poshtë.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç tokës, ndërtesave dhe pronave investuese, të cilat janë matur me vlerën e drejtë. Pasqyrat financiare janë paraqitur në Euro (€), të rrumbullakosura në mijëshin më të afërt (€000), përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

Shoqëria paraqet pasqyrën e pozicionit financiar në mënyrë të përgjithshme sipas rendit të likuiditetit. Një analizë lidhur me rikuperimin ose shlyerjen brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit (jo më shumë se 12 muaj) dhe më shumë se 12 muaj pas datës së raportimit (më shumë se 12 muaj) paraqitet në shënimin përkatës.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me politikat kontabël të shpalosura më tej në këtë shënim kërkon përdorimin e disa vlerësimeve të rëndësishme kontabël. Gjithashtu kërkon që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e aplikimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, apo ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare, janë shpalosur në Shënimin 3: Gjykime të rëndësishme dhe burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim.

Pasqyrat financiare janë përgatitur më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024. Të dhënat aktuale dhe krahasuese të paraqitura në këto pasqyra financiare janë shprehur në mijëra Euro, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe. Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar për t'u përshtatur me ndryshimet në paraqitje për vitin raportues.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Zbatimi i kërkesave të reja IFRS të vlefshme për vitin aktual

Shoqëria ka zbatuar të gjitha Standardet e reja ose të ndryshuara të Kontabilitetit dhe Interpretimet e nxjerra nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (IASB), të cilat janë të detyrueshme për periudhën aktuale raportuese, përveç SNRF 17 dhe SNRF 9. Këto standarde nuk janë zbatuar, bazuar në njoftimin e Bankës Qendrore të Kosovës, të datës 29 dhjetor 2023, për shtyrjen e afatit të zbatimit të këtyre standardeve. Zbatimi i këtyre standardeve, përveç SNRF 17 dhe SNRF 9, si dhe interpretimeve përkatëse, nuk ka pasur ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Standardet dhe ndryshimet e reja në vijim kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2025:

- Mungesa e shkëmbyeshmërisë (Ndryshimet në SNK 21)

Shoqëria aktualisht ndodhet në fazat përfundimtare të vlerësimit të ndikimit të mundshëm të SNRF 17 "Kontratat e sigurimit" në pasqyrat e saj financiare. Në këtë fazë, bazuar në vlerësimin fillestar, menaxhmenti nuk pret një ndikim material në pozicionin financiar apo performancën e Shoqërisë. Megjithatë, duke marrë parasysh kompleksitetin dhe vlerësimin ende në proces të zbatimit, nuk mund të konkludohet në mënyrë përfundimtare se nuk do të ketë ndikim material. Për rrjedhojë, njihet rëndësia e shpalosjes së kësaj pasigurie. Në përputhje me këtë, pranohet se efektet e zbatimit nuk mund të përcaktohen me siguri të plotë në këtë fazë.

Me përjashtim të SNRF 17 dhe nëse nuk është shpalosur ndryshe më sipër, standardet e reja, ndryshimet dhe interpretimet nuk pritet të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Kërkesa të reja të SNRF të publikuara por ende jo në fuqi ose të pazbatuara nga Shoqëria

SNRF 18, si dhe ndryshimet në standardet e tjera, hyjnë në fuqi për periudhat raportuese që fillojnë më ose pas 1 janarit 2027, por lejohet zbatimi i hershëm, i cili duhet të shpaloset. SNRF 18 do të zbatohet në mënyrë retrospektive. Shoqëria aktualisht është duke punuar për të identifikuar të gjitha ndikimet që këto ndryshime do të kenë në pasqyrat financiare kryesore dhe në shënimet përkatëse.

Standardet dhe ndryshimet e tjera që ende nuk janë në fuqi dhe nuk janë zbatuar paraprakisht nga Shoqëria përfshijnë:

- Ndryshimet në klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare (Ndryshime në SNRF 9 dhe SNRF 7) – në fuqi nga 1 janari 2026.
- Kontratat që referojnë energjinë elektrike të varur nga natyra (Ndryshime në SNRF 9 dhe SNRF 7) – në fuqi nga 1 janari 2026.
- Përmirësimet vjetore në Standardet SNRF – Vëllimi 11 – në fuqi nga 1 janari 2026.
- SNRF 19 "Filialet pa përgjegjësi publike: Shpalosjet"
- Ndryshimet në SNRF 19 "Filialet pa përgjegjësi publike: Shpalosjet" – në fuqi nga 1 janari 2027.

Këto standarde dhe ndryshime nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën e aplikimit fillestar dhe për rrjedhojë nuk janë bërë shpalosje shtesë.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

B. MONEDHA FUNKSIONALE DHE E PREZANTIMIT

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare maten duke përdorur monedhën e mjedisit primar ekonomik në të cilin operon Kompania ("monedha funksionale"). Këto pasqyra financiare paraqiten në Euro (€), e cila është monedha funksionale dhe e prezantimit e Kompanisë.

C. PRONA, IMPIANTE DHE PAJISJE

Njohja dhe matja

Pajisjet paraqiten me koston historike minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja historike përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivës.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabël dhe njihen në "Të tjera (shpenzime)/të ardhura" në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Toka dhe ndërtesat paraqiten me vlerat e rivlerësuar. Nëse rivlerësimi rezulton me rritje të vlerës, ajo kreditohet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe akumulohet në rezervën e rivlerësimit, përveç rasteve kur përfaqëson rikthimin e një uljeje të mëparshme të së njëjtës aktivë të njohur si humbje, në të cilin rast njihet në fitim ose humbje.

Ulja që lind si rezultat i rivlerësimit njihet si humbje në masën që tejkalon çdo shumë të kredituar më parë në rezervën e rivlerësimit për të njëjtën aktivë.

Kostot pasuese

Kostot pasuese përfshihen në vlerën kontabël të aktivës ose njihen si një aktivë e veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundshme që përfitimet ekonomike të ardhshme të lidhura me zërin do të rrjedhin tek Kompania dhe kostoja e tij mund të matet në mënyrë të besueshme.

Vlera kontabël e pjesës së zëvendësuar çregjistrohet. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera ngarkohen në fitim ose humbje gjatë periudhës financiare në të cilën ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i pronës, impianteve dhe pajisjeve llogaritet me metodën lineare për të shpërndarë koston e tyre në vlerën e mbetur gjatë jetës së dobishme të vlerësuar, si në vijim:

- | | |
|---|---------|
| • Ndërtesat | 40 vite |
| • Kompjuterët dhe pajisjet përkatëse | 5 vite |
| • Mobiljet, pajisjet dhe inventari tjetër | 5 vite |
| • Automjetet | 5 vite |

Vlerat e mbetura dhe jetët e dobishme të aktiveve rishikohen dhe, nëse është e nevojshme, rregullohen në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar.

D. PRONA INVESTUESE

Pronat investuese maten fillimisht me kosto, duke përfshirë kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, pronat investuese paraqiten me vlerën e drejtë, e cila reflekton kushtet e tregut në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të pronave investuese përfshihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes në vitin në të cilin lindin, duke përfshirë efektin përkatës tatimor. Vlerat e drejta vlerësohen çdo vit nga një vlerësues i jashtëm, i pavarur dhe i akredituar, duke aplikuar një model vlerësimi të rekomanduar nga Komiteti Ndërkombëtar i Standardeve të Vlerësimit. Pronat investuese çregjistrohen kur shiten ose kur tërhiqen përgjithmonë nga përdorimi dhe nuk pritet më asnjë përfitim ekonomik i ardhshëm nga nxjerrja e tyre jashtë përdorimit. Çdo fitim ose humbje nga çregjistrimi ose shitja e pronës investuese njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes në vitin e çregjistrimit ose shitjes. Transferimet bëhen drejt (ose nga) pronave investuese vetëm kur ka një ndryshim në përdorim. Për një transferim nga prona investuese në pronë të përdorur nga pronari, kostoja e supozuar për kontabilizimin e mëtejshëm është vlera e drejtë në datën e ndryshimit të përdorimit. Nëse prona e përdorur nga pronari bëhet pronë investuese, Kompania e kontabilizon këtë pronë në përputhje me politikën për pronë, impiante dhe pajisje deri në datën e ndryshimit të përdorimit.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

E. AKTIVET ME TË DREJTË PËRDORIMI (RIGHT-OF-USE ASSETS)

Një aktiv me të drejtë përdorimi njihet në datën e fillimit të kontratës së qirasë. Aktivi me të drejtë përdorimi matet me kosto, e cila përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë, të rregulluar sipas rastit për çdo pagesë qiraje të kryer në ose para datës së fillimit, minus çdo stimulim të marrë nga qiradhënësi, çdo kosto fillestare direkte të shkaktuar, si dhe – përveç rasteve kur përfshihet në koston e inventarëve – një vlerësim të kostove që pritet të ndodhin për çmontimin dhe largimin e aktivës bazë dhe rikthimin e vendndodhjes ose aktivës në gjendjen fillestare.

Aktivitet me të drejtë përdorimi amortizohen me metodën lineare gjatë periudhës së mbetur të qirasë ose gjatë jetës së dobishme të vlerësuar të aktivës, cilado që është më e shkurtër. Në rastet kur njësia ekonomike pret të marrë pronësinë e aktivës në fund të afatit të qirasë, amortizimi bëhet gjatë jetës së dobishme të vlerësuar të saj. Aktivitet me të drejtë përdorimi janë subjekt i zhvlerësimit ose rregullimeve si rezultat i rimatjes së detyrimeve të qirasë.

Kompania ka zgjedhur të mos njohë aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrime përkatëse të qirasë për qiratë afatshkurtra me afat deri në 12 muaj dhe për qiratë e aktiveve me vlerë të ulët. Pagesat e qirasë për këto aktive njihen si shpenzim në fitim ose humbje gjatë periudhës në të cilën ndodhin.

F. ZHVLERËSIMI I AKTIVEVE JO-FINANCIARE

Zhvlerësimi i pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe i aktiveve jomateriale me jetë të kufizuar

Vlerat kontabël të aseteve jo-financiare rishikohen në çdo datë raportimi për shenja të zhvlerësimit dhe, në rastet kur një aktiv rezulton i zhvlerësuar, ai zvogëlohet si shpenzim përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes deri në vlerën e tij të vlerësuar të rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme është më e larta ndërmjet vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes së aktivitet individual ose njësisë gjeneruese të parasë. Vlera e rikuperueshme përcaktohet për një aktiv individual, përveç rasteve kur aktivi nuk gjeneron flukse monetare hyrëse që janë në masë të madhe të pavarura nga ato të aseteve të tjera ose grupeve të aseteve. Në këtë rast, vlera e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjeneruese të parasë së cilës i përket aktivi.

Vlera në përdorim është vlera aktuale e flukseve monetare të ardhshme të vlerësuar të aktivitet/njësisë. Vlerat aktuale llogariten duke përdorur norma skontimi para tatimit, të cilat reflektojnë vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike të aktivitet/njësisë për të cilën matet zhvlerësimi.

Humbjet nga zhvlerësimi për njësitë gjeneruese të parasë alokohen fillimisht ndaj goodwill-it të njësisë dhe më pas proporcionalisht ndërmjet aseteve të tjera të saj. Rritjet e mëvonshme në vlerën e rikuperueshme, të shkaktuara nga ndryshimet në vlerësime, njihen në fitim ose humbje deri në masën që ato kompensojnë zhvlerësimin e mëparshëm

G. INSTRUMENTET FINANCIARE

Njohja fillestare dhe matja

Kompania njih një aktiv financiar ose një detyrim financiar në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Në njohjen fillestare, Kompania i njih të gjitha aktivitet financiare dhe detyrimet financiare me vlerën e drejtë.

Vlera e drejtë e një aktivi ose detyrimi financiar në njohjen fillestare zakonisht përfaqësohet nga çmimi i transaksionit. Për aktivitet dhe detyrimet financiare që nuk klasifikohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, çmimi i transaksionit përfshin kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e instrumentit financiar.

Kostot e transaksionit të shkaktuara për blerjen e një aktivi financiar ose emetimin e një detyrimi financiar të klasifikuar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes njihen menjëherë si shpenzim.

Kompania njih aktivitet financiare duke përdorur kontabilizimin në datën e shlyerjes (settlement date), pra një aktiv njihet në ditën kur merret nga Kompania dhe çregjistrohet në ditën kur dorëzohet nga Kompania.

Matja pasuese e aktiveve financiare

Matja pasuese e aktiveve financiare varet nga klasifikimi i tyre në momentin e njohjes fillestare. Kompania i klasifikon aktivitet financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

G. INSTRUMENTET FINANCIARE (VAZHDIM)

(a) Huatë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe të arkëtueshmet janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv, përveç atyre që Kompania synon t'i shesë në afat të shkurtër ose që i ka klasifikuar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes apo si të disponueshme për shitje. Huatë dhe të arkëtueshmet njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit, minus provizionin për zhvlerësim. Të arkëtueshmet nga sigurimet, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre si dhe depozitat klasifikohen në këtë kategori.

(b) Pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim

Pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe me maturim të përcaktuar, të ndryshme nga ato që përmbushin përkufizimin e huave dhe të arkëtueshmeve, për të cilat menaxhmenti i Kompanisë ka qëllimin dhe aftësinë pozitive për t'i mbajtur deri në maturim.

Këto pasuri njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit, minus provizionin për zhvlerësim. Provizioni për zhvlerësim për letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim krijohet kur ekziston evidencë objektive se Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumave të detyruara sipas kushteve fillestare. Kompania ka klasifikuar në këtë kategori depozitat afatgjata dhe letrat me vlerë investuese.

Zhvlerësimi i pasurive financiare

Në fund të çdo periudhe raportuese, Kompania vlerëson nëse pasuritë e saj financiare janë zhvlerësuar, bazuar në evidencë objektive se, si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve të ndodhura pas njohjes fillestare, flukset monetare të ardhshme të vlerësuar të pasurisë (ose pasurive) financiare janë ndikuar.

Përveç kësaj, për të arkëtueshmet nga sigurimet që nuk vlerësohen si të zhvlerësuar individualisht, Kompania i vlerëson ato kolektivisht për zhvlerësim, bazuar në përvojën e saj në mbledhjen e pagesave, rritjen e vonesave në portofol dhe ndryshimet e vëzhgueshme në kushtet ekonomike që lidhen me mosshlyerjen e të arkëtueshmeve. Për të arkëtueshmet nga sigurimet, vlera kontabël zvogëlohet përmes përdorimit të një llogarie provizioni dhe rikuperimet pasuese të shumave të fshira më parë kreditohen në këtë llogari. Ndryshimet në vlerën kontabël të provizionit njihen në fitim ose humbje.

Për të gjitha pasuritë e tjera financiare, vlera kontabël zvogëlohet drejtpërdrejt nga humbja e zhvlerësimit.

Për pasuritë financiare të matura me koston e amortizuar, nëse shuma e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet në një periudhë të mëvonshme dhe kjo ulje lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pas njohjes së zhvlerësimit, humbja e njohur më parë rikthehet (drejtpërdrejt ose përmes rregullimit të llogarisë së provizionit për të arkëtueshmet tregtare) nëpërmjet fitimit ose humbjes. Megjithatë, rikthimi nuk duhet të rezultojë në një vlerë kontabël që tejkalon koston e amortizuar që do të kishte pasuria financiare nëse zhvlerësimi nuk do të ishte njohur në datën e rikthimit.

Çregjistrimi

Pavarësisht formës ligjore të transaksioneve, pasuritë financiare çregjistrohen kur ato kalojnë testin "substancia mbi formën" sipas kërkesave të IAS 39.

Ky test përfshin dy lloje vlerësimesh që aplikohen në mënyrë të njëpasnjëshme:

- Vlerësimi i transferimit të rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë
- Vlerësimi i transferimit të kontrollit

Nëse pasuritë njihen/çregjistrohen plotësisht ose pjesërisht (deri në masën e përfshirjes së vazhdueshme të Kompanisë), kjo varet nga analiza specifike e transaksionit.

Matja pasuese e detyrimeve financiare

Detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Në mënyrë tipike, detyrimet ndaj furnitorëve dhe detyrimet e tjera klasifikohen në këtë kategori. Zërat e klasifikuar në këtë kategori zakonisht nuk rimaten, pasi detyrimi është i njohur me një shkallë të lartë sigurie dhe shlyerja është afatshkurtër.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

G. INSTRUMENTET FINANCIARE (VAZHDIM)

Çregjistrimi i detyrimeve financiare

Një detyrim financiar hiqet nga pasqyra e pozicionit financiar vetëm kur detyrimi shlyhet, anulohet ose skadon (pra, shuhet). Diferenca ndërmjet vlerës kontabël të detyrimit financiar të çregjistruar dhe kundërvlerës së paguar njihet në fitim ose humbje.

H. DETYRIMET E QIRASË

Një detyrim qiraje (lease liability) njihet në datën e fillimit të qirasë. Detyrimi i qirasë njihet fillimisht me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që do të kryhen gjatë afatit të qirasë, të skontuara duke përdorur normën e interesit të implikuar në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, normën shtesë të huamarrjes së njësisë ekonomike. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesa fikse të reduktuara me çdo incentivë qiraje të arkëtueshme, pagesa variabile të qirasë që varen nga një indeks ose normë, shumat që pritet të paguhet sipas garancive për vlerën e mbetur, çmimin e ushtrimit të opsionit të blerjes kur ushtrimi i tij është i arsyeshëm të konsiderohet i sigurt, si dhe çdo penalitet të parashikuar për përfundimin e parakohshëm të kontratës. Pagesat variabile të qirasë që nuk varen nga një indeks ose normë njihen si shpenzim në periudhën në të cilën ndodhin.

Detyrimet e qirasë maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Vlerat kontabël rivlerësohen në rast të ndryshimeve në: pagesat e ardhshme të qirasë që rrjedhin nga ndryshimi i një indeksi ose norme të përdorur; garancitë për vlerën e mbetur; afatin e qirasë; sigurinë e ushtrimit të një opsioni blerjeje; si dhe penalitetet për përfundim. Kur një detyrim qiraje rivlerësohet, bëhet një rregullim në aktivin përkatës të së drejtës së përdorimit (right-of-use asset), ose në fitim ose humbje nëse vlera kontabël e këtij aktivi është plotësisht e amortizuar.

Qiratë në të cilat një pjesë e konsiderueshme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënësi klasifikohen si qira operative. Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes në mënyrë lineare gjatë periudhës së qirasë.

I. KLASIFIKIMI I PRODUKTEVE

Kontratat e sigurimit janë kontrata në të cilat Shoqëria (siguruesi) ka pranuar një rrezik të konsiderueshëm sigurimi nga një palë tjetër (mbajtësit e policave), duke u angazhuar të kompensojë mbajtësit e policave nëse një ngjarje e ardhshme e pasigurt dhe e specifikuar (ngjarja e siguruar) ndikon negativisht mbi ta. Si një udhëzim i përgjithshëm, Shoqëria përcakton nëse ka rrezik të konsiderueshëm sigurimi duke krahasuar përfitimet e paguara me përfitimet që do të ishin të pagueshme nëse ngjarja e siguruar nuk do të kishte ndodhur. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë gjithashtu edhe rrezik financiar.

Kontratat investuese janë kontrata që transferojnë rrezik të konsiderueshëm financiar. Rreziku financiar është rreziku i një ndryshimi të mundshëm në të ardhmen në një ose më shumë nga këto elemente: normë interesi e specifikuar, çmim i instrumentit financiar, çmim i mallrave, kurs këmbimi valutor, indeks çmimesh ose normash, vlerësim kreditor ose indeks kreditor, ose ndonjë variabël tjetër, me kusht që në rastin e një variabli jo-financiar, ky variabël të mos jetë specifik për një palë të kontratës. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë gjithashtu rrezik financiar.

Pasi një kontratë klasifikohet si kontratë sigurimi, ajo mbetet kontratë sigurimi për të gjithë kohëzgjatjen e saj, edhe nëse rreziku i sigurimit zvogëlohet ndjeshëm gjatë kësaj periudhe, përveç rasteve kur të gjitha të drejtat dhe detyrimet janë shuar ose kanë skaduar.

J. DETYRIMET NGA KONTRATAT E SIGURIMIT

Njohja dhe matja

Kontratat e sigurimit të përgjithshëm

Detyrimet e sigurimit (insurance liabilities) llogariten veçmas për të gjitha produktet e sigurimit dhe përbëhen nga provizioni për prime (të pafituara), provizioni për rrezik (të papërfunduar) dhe provizioni për dëme (të papaguara në datën e mbylljes së vitit financiar). Detyrimet e sigurimit (provizionet) përfaqësojnë vlerësime të pagesave të ardhshme për dëmet e raportuara dhe të pa raportuara. Shoqëria nuk i skonton detyrimet e saj të sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësime reflektohet në rezultatin e operacioneve në periudhën në të cilën ndodhin ndryshimet në vlerësime. Vlerësimi i

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

J. DETYRIMET NGA KONTRATAT E SIGURIMIT (VAZHDIM)

detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që përfshin pasiguri dhe kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe gjykimeve të informuara.

Primet bruto të shkruara regjistrohen në bazë akruale, sipas kontratave dhe policave të sigurimit të lëshuara gjatë vitit, dhe njihen si të ardhura në mënyrë proporcionale (pro-rata) gjatë afatit të mbulimit përkatës të policës. Primet bruto të shkruara pasqyrojnë biznesin e nënshkruar gjatë vitit dhe nuk përfshijnë asnjë taksë apo detyrim të bazuar në prime. Primet fitohen nga data e fillimit të rrezikut, gjatë periudhës së mbulimit, në bazë të modelit të shpërndarjes së rreziqeve të nënshkruara

Primet e pafituara

Provizioni për primet e pafituara përfshin pjesën proporcionale të primeve bruto të shkruara, e cila vlerësohet të fitohet në vitin financiar pasardhës ose në vitet financiare të mëvonshme. Ky provizion llogaritet veçmas për secilën kontratë sigurimi, duke përdorur metodën ditore pro-rata, dhe rregullohet, nëse është e nevojshme, për të reflektuar çdo ndryshim në shpërndarjen e rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata.

Detyrimet nga kontratat e sigurimit

Detyrimet nga kontratat e sigurimit jo-jetë njihen kur kontratat lidhen dhe primet ngarkohen. Këto detyrime njihen si provizione për dëme të papaguara dhe bazohen në koston përfundimtar të vlerësuar të të gjitha dëmeve të ndodhura por të pashlyera në datën e raportimit, qofshin të raportuara apo jo. Detyrimi çregjistrohet kur kontrata skadon, shlyhet ose anulohet.

Rezerva për primet e pafituara përfshin primet e marra për rreziqe që ende nuk kanë skaduar. Në përgjithësi, kjo rezervë lirohet gjatë afatit të kontratës dhe njihet si e ardhur nga primet.

Në çdo datë raportimi kryhet testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve. Ndryshimet në dëmet e pritura që kanë ndodhur por nuk janë shlyer reflektohen përmes rregullimit të provizionit për dëme të papaguara. Provizioni për rreziqet e pa skaduar rritet në masën që dëmet e ardhshme të pritura për kontratat aktuale të sigurimit tejkalojnë primet e ardhshme plus provizionin aktual për primet e pafituara.

Dëmet nga sigurimet e përgjithshme

Dëmet e ndodhura për sigurimet e përgjithshme përfshijnë dëmet e paguara gjatë vitit financiar së bashku me ndryshimet në vlerësimin e detyrimeve për dëmet e papaguara.

Dëmet e papaguara përfshijnë provizionet për vlerësimin e Kompanisë për koston përfundimtar të shlyerjes së të gjitha dëmeve të ndodhura por të papaguara në datën e raportimit, qofshin të raportuara apo jo, si dhe shpenzimet përkatëse të brendshme dhe të jashtme për trajtimin e dëmeve dhe një marzh prudent.

Megjithëse Menaxhmenti konsideron se detyrimet për dëmet dhe rikuperimet përkatëse nga risigurimi janë të paraqitura në mënyrë të drejtë bazuar në informacionin aktual, detyrimi përfundimtar mund të ndryshojë si rezultat i informacionit dhe ngjarjeve të mëvonshme, dhe mund të kërkojë rregullime të konsiderueshme. Këto rregullime reflektohen në pasqyrat financiare në periudhën në të cilën bëhen.

Provizioni përfaqëson koston përfundimtar të vlerësuar për shlyerjen e të gjitha dëmeve, duke përfshirë kostot direkte dhe indirekte të shlyerjes, që rrjedhin nga ngjarjet e ndodhura deri në datën e raportimit. Humbjet e papaguara dhe shpenzimet për rregullimin e dëmeve përfshijnë vlerësime për dëmet e raportuara dhe provizione për dëmet e pa raportuara. Metoda e përdorur për përcaktimin e provizioneve bazohet në rregullat ligjore përkatëse dhe mbështetet nga vlerësime aktuariale. Provizionet teknike janë llogaritur nga aktuari i Kompanisë, duke marrë parasysh parimet e përcaktuara në rregulloren për llogaritjen e provizioneve teknike për siguresit jo-jetë, të nxjerrë nga Banka Qendrore e Kosovës.

Dëmet e raportuara por të pashlyera (RBNS) përcaktohen rast pas rasti. Rezerva llogaritet si shuma e pritur për t'u paguar dhe rregullohet kur bëhen të disponueshme informacione të reja.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

J. DETYRIMET NGA KONTRATAT E SIGURIMIT (VAZHDIM)

Më 31 dhjetor 2025, provizionet teknike për IBNR për sigurimin MTPL përcaktohen duke përdorur analizën "a-priori" me një qasje të raportit të pritur të humbjeve. Sipas kësaj qasjeje, raporti i pritur i humbjeve përcaktohet për çdo vit nënshkrimi duke përdorur përvojën historike të brendshme të dëmeve dhe, kur është e përshtatshme, informacionin e tregut dhe të krahasimit. Raporti i pritur i humbjeve aplikohet mbi primet e fituara për të vlerësuar koston përfundimtare të dëmeve për çdo periudhë nënshkrimi, nga e cila zbriten dëmet e raportuara por të pashlyera.

Për linjat e sigurimit: Aksident Personal (01), Shëndet (02), Kasko (03) dhe Shëndet në Udhëtim (18), rezerva IBNR përcaktohet duke përdorur metodën aktuariale (metoda **Chain Ladder**) bazuar në zhvillimin historik të dëmeve. Për të gjitha linjat e tjera të sigurimit, rezerva IBNR llogaritet si 10% e primeve bruto të shkruara për vitin përkatës, duke reflektuar natyrën dhe karakteristikat e zhvillimit të dëmeve për këto linja.

Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve ("LAT")

Në çdo datë raportimi, Kompania kryen teste për të siguruar mjaftueshmërinë e rezervave për dëme. Testet kryesore të kryera janë analiza e raportit të dëmeve (Claim Ratio Analysis) dhe analiza "run-off" e rezervave të dëmeve.

Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit për linjat kryesore të biznesit në mënyrë individuale. Llogaritja bëhet si për dëmet e vetme ashtu edhe për dëmet që përfshijnë kostot e blerjes dhe çdo kosto tjetër të jashtme të trajtimit të dëmeve. Gjatë kryerjes së kësaj analize, Kompania merr në konsideratë vlerësimet aktuale të daljeve monetare. Kompania nuk i diskonton këto flukse të vlerësuara monetare pasi shumica e dëmeve pritet të shlyhen brenda një viti.

Përveç kësaj, Kompania kryen çdo vit analizën "run-off" të rezervave për dëme për të vlerësuar metodologjinë e rezervimit. Analiza kryhet veçmas për RBNS dhe IBNR si dhe në mënyrë të kombinuar. Në rast se analiza tregon mospërputhje të rëndësishme, bëhen rregullimet përkatëse në metodologjinë e rezervimit.

Nëse identifikohet një mungesë, ajo njihet menjëherë në fitim ose humbje përmes krijimit të një provizioni për rrezik të pa skaduar që rrjedh nga Testi i Mjaftueshmërisë së Detyrimeve.

Risigurimi

Kompania cedon risigurim në rrjedhën normale të biznesit me qëllim kufizimin e humbjes neto potenciale përmes diversifikimit të rreziqeve që rrjedhin nga linjat MTPL, Pronë dhe Aksidente Personale.

Ky risigurim përfshin marrëveshje fakultative dhe traktate. Vetëm kontratat që rezultojnë në transferim të konsiderueshëm të rrezikut të incidencës dhe kohës kontabilizohen si sigurim. Marrëveshjet e risigurimit nuk e lirojnë Kompaninë nga detyrimet e saj direkte ndaj mbajtësve të policave. Detyrimet nga risigurimi përfshijnë detyrimet për kontratat e risigurimit të jashtëm dhe njihen si shpenzim mbi bazën e shumës së plotë të rënë dakord me risiguresin.

Përfitimet e rimbursuara paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse si dhe në pasqyrën e pozicionit financiar mbi bazë bruto.

Rikuperimet nga risigurimi paraqiten veçmas si pasuri në pasqyrën e pozicionit financiar. Risigurimi dhe rikuperimet e tjera vlerësohen në mënyrë të ngjashme me vlerësimin e dëmeve të papaguara, në përputhje me shumat e lidhura me kontratat bazë të sigurimit dhe sipas kushteve të kontratës së risigurimit.

Kostot e shtyra të përvetësimit (Deferred acquisition costs)

Kostot e përvetësimit përkufizohen si kostot që lindin nga përvetësimi i kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte si komisionet e agjentëve dhe pagesat ndaj Bankës Qendrore të Kosovës.

Kostot e shtyra të përvetësimit dhe kostot e shtyra të origjinimit amortizohen në mënyrë sistematike gjatë jetës së kontratës dhe testohen për zhvlerësim në datën e raportimit. Çdo shumë që nuk është e rikuperueshme njihet si shpenzim. Këto kosto çregjistrohen kur kontratat përkatëse shlyhen ose përfundojnë.

Kostot e trajtimit të dëmeve

Kostot e trajtimit të dëmeve përfshijnë kostot e brendshme dhe të jashtme që lidhen me vlerësimin, trajtimin dhe shqyrtimin e dëmeve nga personeli i Kompanisë, si dhe kostot e jashtme si tarifatat ligjore dhe shpenzime të tjera.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Menaxhmenti ka vlerësuar koston e trajtimit të dëmeve në nivelin 1.2% (2024: 1.2%) të totalit të rezervave RBNS dhe IBNR, duke përjashtuar dëmet e policave kufitare dhe kostot e trajtimit të fondit të garancisë, të cilat përcaktohen nga Byroja Kosovare e Sigurimit.

K. NJOHJA E TË ARDHURAVE

Të ardhurat nga primet

Primet e shkruara nga biznesi i përgjithshëm përfshijnë primet mbi kontratat që hyjnë në fuqi gjatë vitit financiar, pavarësisht nëse ato lidhen tërësisht ose pjesërisht me një periudhë të mëvonshme kontabël. Primet e shkruara paraqiten bruto, pa zbritur komisionet e pagueshme ndërmjetësve. Pjesa e fituar e primeve të arkëtuara njihet si të ardhur. Primet fitohen nga data e fillimit të rrezikut, gjatë periudhës së mbulimit, në bazë të modelit të shpërndarjes së rreziqeve të nënshkruara.

Provizioni për primet e pafituara përfshin pjesën proporcionale të primeve bruto të shkruara, e cila vlerësohet të fitohet në vitin financiar pasardhës, duke përdorur bazën ditore pro-rata 1/365, dhe rregullohet, nëse është e nevojshme, për të reflektuar çdo ndryshim në shpërndarjen e rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata. Megjithatë, të gjitha produktet në fuqi nga Shoqëria kanë rrezik linear dhe aktualisht nuk janë bërë rregullime për variacionet e rrezikut.

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet

Mbajtësve të policave të sigurimit u ngarkohen tarifa për shërbimet e administrimit të policave dhe tarifa të tjera kontraktuale. Këto tarifa dhe komisione njihen si të ardhura gjatë periudhës në të cilën shërbimet përkatëse kryhen.

Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi akumulohen në bazë kohore, duke iu referuar principalit të mbetur dhe normës efektive të interesit, e cila është norma që skanton saktësisht flukset e ardhshme të parave të vlerësuara gjatë jetës së pritshme të aktivitetit financiar deri në vlerën neto kontabël të tij.

L. NJOHJA E DËMEVE DHE SHPENZIMEVE

Përfitimet dhe dëmet

Përfitimet dhe dëmet bruto përfshijnë pagesat për mbajtësit e policave gjatë vitit financiar, si dhe ndryshimet në vlerësimin bruto të detyrimeve nga kontratat e sigurimit dhe investimit, përveç ndryshimeve në provizionin për primet e pafituara, të cilat regjistrohen në të ardhurat nga primet. Gjithashtu përfshihen kostot e brendshme dhe të jashtme të trajtimit të dëmeve që lidhen drejtpërdrejt me përpunimin dhe shlyerjen e dëmeve. Dëmet e sigurimit regjistrohen në bazë të njoftimeve të pranuar.

M. MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTËT E TYRE

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në banka të disponueshme në çdo kohë (on call), si dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet fillestar prej tre muajsh ose më pak.

N. DEPOZITAT ME AFAT

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto të amortizuar dhe klasifikohen sipas maturitetit të tyre. Depozitat me afat me maturitet më të vogël se tre muaj klasifikohen si ekuivalentë të parasë, ndërsa ato me maturitet më të madh se tre muaj klasifikohen si investime në depozita me afat. Interesi llogaritet në bazë akruale.

O. KAPITALI

Kapitali aksionar përfaqëson vlerën nominale të aksioneve të emetuara. Aksionet klasifikohen si kapital (ekuitet) kur nuk ekziston detyrim për transferimin e parasë apo asetëve të tjera.

Rezerva e rivlerësimit

Rezervat janë regjistruar në librat kontabël të Shoqërisë si diferencë ndërmjet vlerës kontabël të tokës dhe ndërtesave dhe vlerës së përcaktuar nga një vlerësues i pavarur.

Humbjet e akumuluar

Humbjet e akumuluar përfshijnë të gjitha fitimet dhe humbjet e periudhës aktuale dhe të periudhave të mëparshme

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

P. TATIMI

Tatimi mbi të ardhurat e korporatave

Me efekt nga 5 gusht 2019, në përputhje me Ligjin nr. 06/L-105 "Për tatimin në të ardhurat e korporatave", kompanitë e sigurimit janë të detyruara të paguajnë tatim mbi të ardhurat e korporatave në normën 10% mbi fitimin e tatueshëm. Norma e tatimit është 10%.

Tatimi aktual është shuma që pritet të paguhet ose të rikuperohet nga autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhën aktuale dhe periudhat e mëparshme. Fitimet ose humbjet e tatueshme bazohen në vlerësime nëse pasqyrat financiare autorizohen para dorëzimit të deklaratave tatimore përkatëse. Tatimet që nuk lidhen me të ardhurat regjistrohen brenda shpenzimeve operative. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi kontabël për shkak se disa të ardhura dhe shpenzime nuk janë kurrë të tatueshme ose të zbritshme, ose sepse koha e njohjes së tyre ndryshon ndërmjet ligjit tatimor dhe trajtimit kontabël.

Shpenzimi i tatimit për periudhën përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë, nëse ka. Tatimi njihet në fitim ose humbje, përveç rasteve kur lidhet me zëra të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejt në kapital. Në këto raste, tatimi njihet përkatësisht në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse ose në kapital. Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat ndërmjet vlerave kontabël të pasurive dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës së tyre tatimore, duke përdorur metodën e detyrimit në bilanc.

Detyrimet për tatim të shtyrë njihen përgjithësisht për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme, ndërsa pasuritë për tatim të shtyrë njihen në masën që është e mundshme që fitime të tatueshme të ardhshme do të jenë të disponueshme për të përdorur diferencat e përkohshme të zbritshme.

Vlera kontabël e pasurive për tatim të shtyrë rishikohet në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe zvogëlohet në masën që nuk është më e mundshme që fitime të mjaftueshme të tatueshme do të jenë në dispozicion për të lejuar rikuperimin e tyre.

Tatimi i shtyrë llogaritet duke përdorur normat tatimore që pritet të aplikohen në periudhën kur detyrimi do të shlyhet ose pasuria do të realizohet. Tatimi i shtyrë ngarkohet ose kreditohet në fitim ose humbje, përveç rasteve kur lidhet me zëra të njohur drejtpërdrejt në kapital, në të cilin rast ai gjithashtu njihet në kapital.

Pasuritë dhe detyrimet për tatim të shtyrë kompensohen kur ekziston një e drejtë ligjore e detyrueshme për të kompensuar pasuritë tatimore aktuale me detyrimet tatimore aktuale dhe kur ato lidhen me tatime mbi të ardhurat të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor, dhe Kompania synon të shlyejë mbi bazë neto.

Të ardhurat nga interesi të pranuar nga Kompania i nënshtrohen gjithashtu tatimit në burim në normën 10% (2024: 10%).

Q. PËRFITIMET E PUNONJËSVE

Kosto e përfitimeve të pensionit

Kompania nuk krijon provizione dhe nuk ka detyrime për pensione të punonjësve përtej kontributeve të paguara në skemën shtetërore të pensioneve, Trusti Pensional i Kosovës (KPST).

R. PROVIZIONET

Një provizion njihet kur Kompania ka një detyrim aktual si rezultat i një ngjarjeje të kaluar dhe është e mundshme që një dalje e burimeve që përmbajnë përfitime ekonomike do të kërkohet për shlyerjen e këtij detyrimi, dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit. Provizionet rishikohen në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe rregullohen për të reflektuar vlerësimin më të mirë aktual. Kur efekti i vlerës kohore të parasë është material, shuma e provizionit është vlera aktuale e shpenzimeve që pritet të kërkohen për shlyerjen e detyrimit. Provizionet nuk njihen për humbje të ardhshme operative.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

S. QIRATË

Qiratë afatshkurtra dhe qiratë për pasuri me vlerë të ulët njihen si shpenzim në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Qiratë afatshkurtra janë qiratë me afat 12 muaj ose më pak.

T. NJOHJA E SHPENZIMEVE

Pagesat për qira operative

Pagesat sipas qirave operative njihen në fitim ose humbje në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë. Kompania nuk kapitalizon qiratë me pagesë vjetore nën 5,000 Euro ose me maturim më të shkurtër se një vit.

Kostot financiare

Interesi i paguar njihet në fitim ose humbje sipas parimit të aktualit dhe llogaritet duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Interesi i akumuluar përfshihet në vlerën kontabël të detyrimit financiar që mbart interes.

U. ANGAZHIMET DHE KONTIGJENCAT

Detyrimet kontigjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen, përveç rasteve kur mundësia e një daljeje të burimeve që përmbajnë përfitime ekonomike është e largët. Një pasuri kontigjente nuk njihet në pasqyrat financiare, por shpaloset kur një hyrje e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Shuma e një humbjeje kontigjente njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme do të konfirmojnë ekzistencën e një detyrimi në datën e pasqyrës së pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

V. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Palët e lidhura përfshijnë aksionarët dhe drejtorët e Kompanisë, së bashku me njësitë që ata kontrollojnë, të cilat mund të ushtrojnë ndikim të rëndësishëm mbi operacionet dhe menaxhimin e Kompanisë. Në vlerësimin e çdo marrëdhënieje të mundshme me palë të lidhura, merret në konsideratë thelbi ekonomik i marrëdhënies dhe jo vetëm forma ligjore.

W. NGJARJET PAS PERIUdhËS SË RAPORTIMIT

Ngjarjet pas periudhës së raportimit që ofrojnë informacione shtesë për pozicionin e Kompanisë në datën e pasqyrës së pozicionit financiar (ngjarje rregulluese) reflektohen në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas periudhës së raportimit që nuk janë rregulluese shpalosen në shënime kur janë materiale.

X. PARIMI I VIJMËSISË

Më 31 dhjetor 2025, Shoqëria ka raportuar aktive neto në shumën prej 8,045 mijë euro (2024: 7,191 mijë euro) dhe fitim për vitin në shumën prej 854 mijë euro (2024: 758 mijë euro), ndërsa humbjet e akumuluarat kanë arritur në 11,992 mijë euro (31 dhjetor 2024: 12,846 mijë euro). Shoqëria ka gjeneruar fitime gjatë viteve të fundit dhe menaxhmenti parashikon që rentabiliteti do të vazhdojë edhe në të ardhmen e parashikueshme. Për më tepër, Shoqëria përmbush të gjitha kërkesat rregullative të kapitalit në fuqi, përfshirë marzhet e solvencës dhe mbulimin adekuat të rezervave teknike (matematike) me aktivet e pranueshme.

Bazuar në sa më sipër, menaxhmenti ka konkluduar se nuk ekzistojnë pasiguri materiale që mund të vënë në dyshim në mënyrë të konsiderueshme aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin si një subjekt në vijimësi (going concern). Aftësia e Shoqërisë për të vazhduar operacionet e saj nuk varet nga mbështetja financiare e aksionarit të saj. Megjithatë, nëse do të kërkohej mbështetje shtesë, aksionari ka dëshmuar në të kaluarën aftësinë dhe gatishmërinë për të ofruar mbështetje financiare.

3. GJYKIMET E RËNDËSISHME DHE BURIMET KRYESORE TË PASIGURISË NË VLERËSIM

Kompania bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve gjatë vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritjet për ngjarje të ardhshme që konsiderohen të arsyeshme dhe relevante në rrethanat përkatëse. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën bëhet rishikimi nëse ai ndikon vetëm atë periudhë, ose në periudhën e rishikimit dhe në periudhat e ardhshme nëse ndikon si periudhën aktuale ashtu edhe ato të ardhshme.

Vlerësimi i detyrimeve nga kontratat e sigurimit

Për kontratat e sigurimit jo-jetë (non-life), duhet të bëhen vlerësime si për koston përfundimtare të pritshme të dëmeve të raportuara në datën e pozicionit financiar, ashtu edhe për koston përfundimtare të pritshme të dëmeve të ndodhura por ende të pa raportuara në datën e pasqyrave financiare (IBNR – Incurred But Not Reported). Kostoja përfundimtare e dëmeve të papaguara vlerësohet duke përdorur një sërë teknikash standarde aktuariale për zhvillimin e dëmeve.

Supozimi kryesor që qëndron pas këtyre teknikave është se përvoja historike e zhvillimit të dëmeve të një kompanie mund të përdoret për të projektuar zhvillimin e dëmeve të ardhshme dhe, rrjedhimisht, koston përfundimtare të dëmeve. Në këtë mënyrë, këto metoda theksojnë zhvillimin e dëmeve të paguara dhe të ndodhura, koston mesatare të një dëmi dhe numrin e dëmeve, bazuar në zhvillimet e vërejtura në vitet e mëparshme dhe në raportet e pritshme të dëmeve. Zhvillimi historik i dëmeve analizohet kryesisht sipas viteve të aksidentit, por mund të analizohet më tej edhe sipas zonave gjeografike, linjave të rëndësishme të biznesit dhe llojeve të dëmeve. Përveç kësaj, përdoret edhe vlerësimi cilësor për të vlerësuar në çfarë mase trendet historike mund të mos jenë të aplikueshme në të ardhmen, me qëllim arritjen e kostos së vlerësuar përfundimtare të dëmeve, e cila përfaqëson rezultatin e mundshëm nga një gamë e rezultateve të mundshme, duke marrë parasysh të gjitha pasiguritë përkatëse.

Humbjet nga zhvlerësimi i të arkëtueshmeve

Kompania rishikon të arkëtueshmet nga sigurimet dhe ato jo nga sigurimet për të vlerësuar zhvlerësimin të paktën një herë në vit. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të njihet në fitim ose humbje, Kompania bën gjykime nëse ekzistojnë të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë një rënie të matshme në flukset monetare të ardhshme të vlerësuara nga një debitor individual. Këto të dhëna mund të përfshijnë evidencë të ndryshimeve negative në statusin e pagesave të debitorit.

Vlerësimi i vlerës së drejtë të pronave investuese dhe pronave të përdorura nga pronari

Pronat investuese dhe pronat e përdorura nga pronari maten me vlerën e drejtë për qëllime raportimi financiar. Në vlerësimin e vlerës së drejtë të një pasurie, Kompania bashkëpunon ngushtë me vlerësues të jashtëm të kualifikuar që kryejnë vlerësimin duke përdorur teknika të përshtatshme dhe inpute në modele (p.sh. qasja e krahasimit të tregut, analiza e flukseve monetare të diskontuara, etj.). Çmimet e përcaktuara nga vlerësuesit përdoren nga Kompania pa rregullime të mëtejshme. Ndryshimet në vlerën e drejtë të pasurive dhe shkaqet e tyre analizohen nga menaxhmenti. Këto vlerësime kërkojnë që Kompania të zgjedhë ndërmjet metodologjive të ndryshme të vlerësimit dhe të bëjë vlerësime për flukset monetare të ardhshme, normat e diskontimit dhe çmimet e tregut.

4. SIGURIMI DHE RREZIKU FINANCIAR

A. Korniza e qeverisjes

Objektivi kryesor I kornizës së menaxhimit të rrezikut dhe financiar të Kompanisë është mbrojtja e aksionarëve nga ngjarjet që pengojnë arritjen e qëllimeve të qëndrueshme të jesham ë ces financiare, duke përfshirë dështimin për të shfrytëzuar mundësitë. Menaxhmenti kyç njih rëndësinë kritike të pasjes së sistemeve efikase dhe efektive të menaxhimit të rrezikut.

Bordi I Drejtorëve miraton politikat e menaxhimit të rrezikut dhe mblidhet rregullisht për të aprovuar kërkesat komerciale, rregullatore dhe organizative të këtyre politikave. Këto politika përcaktojnë identifikimin e rrezikut nga Kompania dhe interpretimin e tij, strukturën e kufijve për të siguruar cilësinë dhe diversifikimin e duhur të pasurive, përafrimin e strategjisë së nënshkrimit dhe risigurimit me objektivat korporative, si dhe specifikojnë kërkesat për raportim.

B. Korniza rregullatore

Operacionet e Kompanisë janë subjekt I kërkesave rregullatore në juridiksionet ku ajo operon. Këto rregullore jo vetëm që përcaktojnë miratimin dhe monitorimin e aktiviteteve, por gjithashtu vendosin dispozita kufizuese (p.sh. kërkesa për mjaftueshmëri kapitali dhe marzhat e solvencës) për të minimizuar rrezikun e mosshlyerjes dhe falimentimit të kompanive të sigurimit, si dhe për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të paparashikuara.

C. Strategjia e risigurimit

Jesham ë e madhe e biznesit të ceduar në risigurim vendoset mbi bazë **excess-of-loss** (tejkalim humbjeje). Shumat e rikuperueshme nga risiguruesit vlerësohen në mënyrë konsistente me provizionet për dëmet e papaguara dhe janë në përputhje me kontratat e risigurimit. Megjithëse Kompania ka marrëveshje risigurimi, ajo nuk lirohet nga detyrimet e saj direkte ndaj mbajtësve të policave. Si rrjedhojë, ekziston ekspozim kreditor ndaj risigurimit të ceduar, në rast se ndonjë risigurues nuk përmbush detyrimet e tij sipas marrëveshjeve përkatëse. Vendosja e risigurimit nga Kompania është e diversifikuar në mënyrë që të mos varet nga një risigurues I vetëm.

D. Rreziku I sigurimit

Rreziku kryesor me të cilin përballlet Shoqëria në kuadër të kontratave të sigurimit është që dëmet dhe pagesat e përfitimeve reale, ose koha e ndodhjes së tyre, të ndryshojnë nga pritshmëritë. Ky rrezik ndikohet nga frekuenca e dëmeve, shkalla e tyre, përfitimet reale të paguara si dhe zhvillimi I mëvonshëm I dëmeve afatgjata. Për këtë arsye, objektivi i Shoqërisë është të sigurojë që të jenë të disponueshme rezerva të mjaftueshme për mbulimin e këtyre detyrimeve.

Ekspozimi ndaj rrezikut zbutet përmes diversifikimit të një portofoli të madh të kontratave të sigurimit dhe zonave gjeografike. Ndryshueshmëria e rreziqeve përmirësohet gjithashtu përmes përzgjedhjes dhe zbatimit të kujdesshëm të udhëzimeve të strategjisë së nënshkrimit (underwriting), si dhe përdorimit të marrëveshjeve të risigurimit.

Shoqëria blen risigurim si pjesë e programit të saj për menaxhimin e rrezikut. Risigurimi i ceduar vendoset si në bazë proporcionale ashtu edhe jo-proporcionale. Pjesa më e madhe e risigurimit proporcional është risigurim me kuotë (quota-share), i cili përdoret për të reduktuar ekspozimin e përgjithshëm të Shoqërisë ndaj klasave të caktuara të biznesit. Risigurimi jo-proporcional është kryesisht risigurim "excess of loss", i projektuar për të zbutur ekspozimin neto të Shoqërisë ndaj humbjeve katastrofike. Kufijtë e mbajtjes (retention limits) për risigurimin "excess of loss" ndryshojnë sipas linjës së produktit dhe territorit.

Shumat e rikuperueshme nga risiguruesit vlerësohen në mënyrë konsistente me provizionin për dëmet e papaguara dhe në përputhje me kontratat e risigurimit. Megjithëse Shoqëria ka marrëveshje risigurimi, ajo nuk lirohet nga detyrimet e saj direkte ndaj mbajtësve të policave dhe si rrjedhojë ekziston ekspozim kreditor në lidhje me sigurimet e ceduar, në masën që ndonjë risigurues nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij sipas marrëveshjeve të risigurimit.

Shoqëria lëshon kryesisht llojet e mëposhtme të kontratave të sigurimit: sigurimi i detyrueshëm ndaj palëve të treta në motorikë, sigurimi shëndetësor, sigurimi i pronës, sigurimi i përgjegjësisë profesionale dhe kontrata të tjera sigurimi.

KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGURIA SH.A.
PASQYRAT PLOTËSUESE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025
(Shumat në mijëra EUR, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe)

4. SIGURIMI DHE RREZIKU FINANCIAR (VAZHDIM)

D. Rreziku I sigurimit (vazhdim)

Për sigurimin motorik ndaj palëve të treta, rreziqet më të rëndësishme janë dëmet materiale dhe jo-materiale të shkaktuara nga aksidentet. Për sigurimin e pronës dhe atë shëndetësor, rreziqet më të rëndësishme janë: fatkeqësitë natyrore, zjarri, aktivitetet terroriste, epidemitë, si dhe zhvillimet në shkencën dhe teknologjinë mjekësore.

Qëllimi i këtyre strategjive të nënshkrimit (underwriting) dhe risigurimit është të kufizojnë ekspozimin ndaj ngjarjeve katastrofike, në përputhje me oreksin për rrezik të Shoqërisë, siç përcaktohet nga menaxhmenti. Retencionet maksimale të sigurimit janë 10% e kapitalit aksionar minimal

Tabela më poshtë përcakton përqendrimin e detyrimeve të kontratave të sigurimit jo-jetë sipas llojit të kontratës:

31 Dhjetor 2025

	Detyrimet Bruto	Risigurimi i detyrimeve	Detyrimet Neto
Sigurimet e Përgjegjësisë Motorike ndaj Palëve të Treta	8,357	187	8,170
BKS	987	52	935
Fondi i Kompenzimit	922	-	922
Sigurimi i Pronës	739	503	236
Sigurimi shëndetësor	385	-	385
Produkte të tjera	1,041	39	1,002
GJITHSEJ	12,431	781	11,650

31 Dhjetor 2024

	Detyrimet Bruto	Risigurimi i detyrimeve	Detyrimet Neto
Sigurimet e Përgjegjësisë Motorike ndaj Palëve të Treta	7,513	200	7,313
BKS	880	53	827
Fondi i Kompenzimit	915	-	915
Sigurimi i Pronës	757	503	254
Sigurimi shëndetësor	500	-	500
Produkte të tjera	980	126	854
GJITHSEJ	11,545	882	10,663

E. Rreziku Kreditor

Kompania nuk ka përqendrim të konsiderueshëm të riskut kreditor. Kompania ka politika që limitojnë shumën e riskut kreditor për çdo palë të vetme të kundërt. Ekspozimi maksimal i Kompanisë ndaj riskut kreditor përfaqësohet nga vlera kontabël e çdo pasurie financiare në Pasqyrën e pozicionit financiar.

	31 Dhjetor 2025 EUR'000	31 Dhjetor 2024 EUR'000
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	1,082	870
Depozitat me afat	14,505	11,682
Investimet ne letra me vlere	4,125	5,082
Të arkëtueshmet nga sigurimet	1,753	1,299
EKSPOZIMI MAKSIMAL NDAJ RISKUT KREDITOR	21,465	18,933

Depozitat me Afat dhe Paraja dhe Ekuivalentët e saj

Të gjitha depozitat me afat, dhe paratë e gatshme të mbajtura në llogarinë rrjedhëse janë në bankat e licencuara të Republikës së Kosovës. Sidoqoftë, ekspozimi ndaj një banke të vetme nuk duhet të kalojë 30% të depozitave me afat sipas politikave të Kompanisë dhe rregulloreve të BQK-së.

Investimet në letra me vlerë janë ne letra me vlerë të lëshuara nga Republika e Kosovës dhe nuk kanë vlersim kreditor.

KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGURIA SH.A.
 PASQYRAT PLOTËSUESE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025
 (Shumat në mijëra EUR, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe)

4. SIGURIMI DHE RREZIKU FINANCIAR (VAZHDIM)

E. Rreziku kreditor (vazhdim)

Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimet.

Kompania menaxhon në mënyrë aktive përzierjen e produkteve të saj për të siguruar që nuk ka ndonjë përqendrim domethënës të riskut kreditor. Struktura e vjetërsisë së llogarive të arkëtueshme nga sigurimet deri më 31 Dhjetor 2025 dhe 2024 është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2025 EUR'000	31 Dhjetor 2024 EUR'000
Deri në 30 ditë	727	360
Nga 1 deri 3 muaj	346	115
Nga 3 deri 6 muaj	269	446
Mbi 6 muaj	386	189
Mbi 1 vit	491	515
	2,219	1,625
Minus: provizioni i humbjes në vlerë	(466)	(326)
LLOGARITË E ARKËTUESHME NGA SIGURIMET, NETO	1,753	1,299

Lëvizjet në provizion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme nga primet që janë vlerësuar për humbje në vlerë kolektivisht janë si vijon:

	31 Dhjetor 2025 EUR'000	31 Dhjetor 2024 EUR'000
Më 1 Janar	326	256
Të njohura gjatë vitit	140	70
Më 31 Dhjetor	466	326

4 RISKU I SIGURIMIT DHE RISKU FINANCIAR (VAZHDIM)

F. Rrezikui Tregut

Kompania merr përsipër ekspozimin ndaj risqeve tregtare. Risqet tregtare lindin nga pozicionet e hapura në (a) valutat e huaja dhe (b) pasuritë dhe detyrimet që mbajnë interes. Menaxhmenti përcakton kufijtë mbi vlerën e riskut që mund të pranohet, i cili monitorohet në baza ditore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasjeje nuk parandalon humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve të konsiderueshme të tregut.

Risku i Normës së Interesit

Ekspozimi i Kompanisë ndaj riskut të interesit lidhet me depozitat e vendosura në bankat lokale tregtare. Dëmet dhe provizionet e papaguara për primet e pa-fituara nuk janë drejtpërdrejtë të ndjeshme ndaj normave të interesit të tregut, sepse ato nuk janë të zbritura dhe nuk mbartin interes.

31 Dhjetor 2025	Instrumentet financiare me normë interesi të përcaktuar					Që nuk bartin interes EUR'000
	GJITHSEJ EUR'000	<1 muaj EUR'000	1-3 muaj EUR'000	3-12 muaj EUR'000	12> muaj EUR'000	
PASURITË						
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	1,082	-	-	-	-	1,082
Depozitat me afat	14,505	323	1,094	6,337	6,751	-
Investimet ne letra me vlere	4,125	-	1,005	-	3,120	-
Të arkëtueshmet nga sigurimi	1,753	-	-	-	-	1,753
GJITHSEJ	21,465	323	2,099	6,337	9,871	2,835
DETYRIMET						
Detyrimet për provizione teknike	(12,431)	-	-	-	-	(12,431)
Detyrimet nga sigurimi dhe detyrime të tjera	(214)	-	-	-	(214)	-
Detyrimet ndaj Borxhit të varur	(573)	-	-	-	-	(573)
Detyrimet e Qirasë	(356)	(12)	(25)	(108)	(211)	-
GJITHSEJ	(13,574)	(12)	(25)	(108)	(425)	(13,004)
DIFERENCA E MATURITETIT	7,891	311	2,074	6,229	9,446	(10,169)

31 Dhjetor 2024	Instrumentet financiare me normë interesi të përcaktuar					Që nuk bartin interes EUR'000
	GJITHSEJ EUR'000	<1 muaj EUR'000	1-3 muaj EUR'000	3-12 muaj EUR'000	12> muaj EUR'000	
PASURITË						
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	870	-	-	-	-	870
Depozitat me afat	11,682	322	411	2,711	8,238	-
Investimet ne letra me vlere	5,082	-	-	-	5,082	-
Të arkëtueshmet nga sigurimi	1,299	-	-	-	-	1,299
GJITHSEJ	18,933	322	411	2,711	13,320	2,169
DETYRIMET						
Detyrimet për provizione teknike	(11,545)	-	-	-	-	(11,545)
Detyrimet nga sigurimi dhe detyrime të tjera	(765)	-	-	-	-	(765)
Detyrimet ndaj Borxhit të varur	(200)	-	-	-	(200)	-
Detyrimet e Qirasë	(324)	-	-	-	(322)	-
GJITHSEJ	(12,834)	-	-	-	(524)	(12,310)
DIFERENCA E MATURITETIT	6,099	322	411	2,711	12,796	(10,141)

4 RISKU I SIGURIMIT DHE RISKU FINANCIAR (VAZHDIM)

G. Rreziku i valutave të huaja

Kompania nuk është e ekspozuar ndaj riskut të kursit të këmbimit sepse të gjitha transaksionet e saj kryhen në valutën vendase.

H. Rreziku i Likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Kompania nuk mund të përmbushë detyrimet e saj që lidhen me detyrimet financiare në kohën kur ato janë në afat.

Menaxhimi i riskut prudent të likuiditetit nënkupton mbajtjen e mjaftueshme të parave të gatshme dhe ekuivalentëve të saj, atëherë, disponueshmëria e fondeve nëpërmjet linjave adekuate kreditore dhe aftësisë për të arkëtuar në kohën e duhur, brenda afateve të përcaktuara shumat e paguara nga depozitat.

Tabela e mëposhtme analizon aktivet dhe detyrimet financiare të Kompanisë më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 në maturimin përkatës kontraktual të mbetur

31 Dhjetor 2025	Deri në 1				GJITHSEJ
	muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	Mbi 1 vit	
	EUR'000	EUR'000	EUR'000	EUR'000	EUR'000
PASURITË					
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	1,082	-	-	-	1,082
Depozitat me afat	323	1,094	6,337	6,751	14,505
Investimet ne letra me vlere	-	1,005	-	3,120	4,125
Të arkëtueshmet nga sigurimet	727	346	562	118	1,753
GJITHSEJ	2,132	2,445	6,899	9,989	21,465
DETYRIMET					
Detyrimet e provizioneve teknike	(12,431)	-	-	-	(12,431)
Detyrimet nga sigurimi dhe detyrime të tjera	573	-	-	-	(573)
Detyrimet ndaj Borxhit të varur	-	-	-	(214)	(214)
Detyrimet e Qirasë	(12)	(25)	(108)	(211)	(356)
GJITHSEJ	(13,016)	(25)	(108)	(425)	(13,575)
DIFERENCA E MATURITETIT	(10,884)	2,420	6,791	9,564	7,891

